V E N D I M
Nr.595, datë 9.9.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVO-TOKËSORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Me propozimin e sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.6.1992 "Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

1. Në rrethin e Tiranës

- Fshati Laknas shkëputet nga komuna Bërxull dhe kalon në Bashkinë Kamëz.

2. Në rrethin e Lezhës

- Fshati Gajush shkëputet nga komuna Zejmen dhe kalon në komunën Shënkoll.

3. Në rrethin e Malësisë së Madhe.

- Fshati Kokpapaj shkëputet nga komuna Gruemirë dhe kalon në komunën Shkrel.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për efektet e përdorimit të fondeve për ndihmën ekonomik ky vendim, si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave nr.526, datë 12.8.1996, nr.581, datë 2.9.1996 dhe nr.582, datë 12.8.1996 hyjnë në fuqi më 1 nëntor 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi